



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:283777  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05876278

KPPP.nr.2191/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Joos & Krasniqi-Bazë” Sh.P.K., me adresë në Junik 51050, me NUI: 810962309, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Florim Shefqeti me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.439/23 të datës 27.11.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fazli Gjonbalaj me seli të zyrës në Mitrovicë, jashtë seancës me datë 19.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.439/23 të datës 27.11.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fazli Gjonbalaj, dhe i njehti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit, në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.439/23 të datës 27.11.2023, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës nr.K-

23/005, dhe faturës K-23/004 të datës 04.07.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit borxhin në lartësi prej 83,117.00 Euro, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, për shkak të cenimit qenësor të rregullave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tej ka theksuar se fatura mbi të cilat bazohet propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet esenciale për faturë të paraparë me nenin 22 lidhur me nenin 29 të LPP-së, dhe si e tillë nuk mund të jetë objekt përbarimi, pasi që e njëjta duhet të jetë e nënshkruar nga dy palët, si kreditori ashtu edhe debitori, të ceket afati për pagesë, e poashtu duhet të dihet burimi i asaj fature. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të abrogohet urdhri për përbarim P.nr.439/23 i datës 27.11.2023.

Kreditori, në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, me arsyetimin se faturat janë të protokolluara nga ana e debitorit-Komuna e Prishtinës e që nënkuptohet se të dyja faturat janë pranuar nga debitori. Më tej ka theksuar se prapësimi nga debitori është bërë me tentimin për t'iu shmangur pagesës së detyrimeve ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet, ndërsa urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat të vërtetohet, si dhe të obligohet debitori t'ia paguajë shpenzimet e procedurës përbarimore dhe atë për përpilimin e propozimit për përbarim shumë prej 312 Euro, përgjigjes në prapësim në shumë prej 624 Euro, dhe shpenzimet tjera të procedurës që do të krijohen.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentet e besueshme faturën nr.K-23/005, dhe faturën K-23/004 të datës 04.07.2023, në kopje të vërtetuar sipas ligjit, dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimit të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par.1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2191/23, me datë 19.06.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.